

# KESHILLI I LARTE I PROKURORISE

BULETIN INFORMATIV, DHJETOR 2023



# SEANCË PLENARE, 14 DHJETOR 2023



Më datë 14 dhjetor 2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë u mbledh në mbledhjen e radhës plenare. Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit, zotit Tartar Bazaj dhe në mungesë të kreut të tij, z. Alfred Balla dhe z. Sokol Stojani. Gjithashtu, të pranishëm ishin si gjithnjë përfaqësues nga misioni OPDAT dhe EU4JUSTICE. Mbledhja nisi me miratimin e dy procesverbaleve të Seancave Plenare të datave 13.11.2023 dhe 30.11.2023.

Në vijim u miratuan vendimet si më poshtë:

1. Komandimin e prokurores Ervisa Hyka në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme;
2. Caktimin e Relatorit dhe Këshilltarit Ligjor përgjegjës, për vlerësimin e kandidatëve që kanë rikandiduar në pozicionin e drejtuesit të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Durrës dhe në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pas shortimit rezultoi për:
  - a. Prokuroren Anita Jella, Relator zoti Zeqir Hoda, Këshilltar Ligjor Olger Rumnici;
  - b. Prokurorin Genti Xholi, Relator zonja Ledina Riza, Këshilltar Ligjor Andi Pogaçe;
  - c. Prokurorin Kreshnik Ajazi, Relator zonja Nurihan Seiti, Këshilltar Ligjor Armida Moçka.
3. Pezullimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për prokurorin Mustafa Turku dhe Moisi Duda;
4. Përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, për prokurorin Përparim Vukaj;
5. Verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, zotit Ervin Zoto dhe miratimin e listës pjesore të kandidatëve për student në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024;
6. Zëvendësimin e zotit Artur Cara, me zotin Ylli Pjetërnikaj, si Këshilltar Ligjor përgjegjës për vlerësimin;
7. Miratimin e caktimit të përkohshëm të zonjës Enkeleda Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, të ushtrojë funksionin e drejtuesit të kësaj prokurorie edhe për një periudhë tre mujore;
8. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Elida Kaçkini.

# Seancë Plenare, 28 Dhjetor 2023



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Më 28 dhjetor 2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen e fundit plenare për vitin 2023. Mbledhja u mbajt në prani të dhjetë (10) anëtarëve, përfaqësuesëve të programeve OPDAT dhe EU4JUSTICE si dhe në mungesë të zonjës Mirela Bogdani.

Gjatë kësaj mbledhjeje u miratuan vendimet si më poshtë:

- 1. Procesverbali i Seancës Plenare të datës 14.12.2023.
- 2. Vendimi për “Caktim të përkohshëm të prokurorit Dritan Gripshi në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat” edhe për një periudhë tjetër tremujore.;
- 3. Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”;
- 4. Vendimi “Për caktimin me short të Relatorit dhe Këshilltarit Ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve, përgjatë vitit 2024”.

# NË PËRFUNDIM TË SHORTIT U PËRCAKTUAN RELATORET DHE KESHILLTARET, SI VIJON

## PROKURORI I SHORTUAR PËR VLERËSIM

## RELATORI ANËTAR I KËSHILLIT

## KËSHILLTAR I LIGJOR PËRKATËS

1	Albert Demirneli	M.Duda	G.Habazaj
2	Albert Murçaj	T.Bazaj	Y.Pjetërnikaj
3	Arben Agovi	T.Bazaj	G.Habazaj
4	Arbër Berexha	O.Eminaj	A.Pogaçe
5	Arian Xhaferraj	M.Duda	G.Habazaj
6	Artur Ismajlukaj	O.Eminaj	G.Habazaj
7	Aurel Zarka	M.Duda	A.Pogaçe
8	Dashnor Nure	M.Duda	A.Moçka
9	Deniona Katro	T.Bazaj	O.Rumnici
10	Dhorina Theodhori	T.Bazaj	A.Moçka

11	Edina Kurti	O.Eminaj	Y.Pjetërnikaj
12	Edmond Koloshi	O.Eminaj	O.Rumnici
13	Elsa Kareci	M.Duda	G.Habazaj
14	Enkeleda Xhengo	T.Bazaj	O.Rumnici
15	Enklid Gjini	O.Eminaj	A.Pogaçe
16	Erion Imeraj	M.Duda	A.Moçka
17	Erion Shehaj	O.Eminaj	A.Pogaçe
18	Genci Mane	O.Eminaj	A.Pogaçe
19	Hysni Mula	M.Duda	O.Rumnici
20	Irena Çunoti	M.Duda	G.Habazaj
21	Irma Balli	M.Duda	A.Pogaçe
22	Julian Çafka	T.Bazaj	A.Moçka
23	Kledian Llaho	M.Duda	A.Moçka
24	Leonard Filopati	T.Bazaj	Y.Pjetërnikaj
25	Madrid Kullolli	T.Bazaj	A.Pogaçe
26	Marsida Frashëri	T.Bazaj	Y.Pjetërnikaj
27	Ornela Rrumbullaku	T.Bazaj	Y.Pjetërnikaj
28	Pali Decolli	O.Eminaj	O.Rumnici
29	Petref Asllani	T.Bazaj	O.Rumnici
30	Pranvera Stafa	O.Eminaj	Y.Pjetërnikaj
31	Silvana Lule	M.Duda	A.Moçka
32	Sokol Nishani	O.Eminaj	A.Moçka
33	Suela Salavaçi	O.Eminaj	G.Habazaj
34	Shqiponja Milla	M.Duda	O.Rumnici
35	Xheljan Seferi	T.Bazaj	A.Pogaçe
36	Xhoana Mehmetaj	O.Eminaj	Y.Pjetërnikaj
37	Zena Lila	T.Bazaj	A.Moçka

# RENDITJA E 8 KANDIDATËVE PËR PROKURORË NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë i Prokurorisë u mbledh në seancë plenare në prani të 11 anëtarëve, me pjesëmarrjen e partnerëve ndërkombëtarë të misioneve OPDAT dhe EU4JUSTICE. Pasi zhvilloi dëgjесat me të tetë kandidatët, votoi me anë të pikëzimit për ta, në përfundim konkludoi renditja e tyre si më poshtë:

Ols Dado  
Anita Jella  
Ndini Tavani  
Bledar Maksuti  
Kreshnik Ajazi  
Pali Deçolli  
Albert Kuliçi  
Sonila Muhametaj

Lista me tre kandidaturat e para do ti përcillet SPAK-ut për të vazhduar më tej kontrollin e pasurisë dhe figurës së tyre dhe në përfundim të kësaj procedure, Këshilli do të emëroj tre prokurorët e rinj.




# VEPRIMTARIA E KLP-së DHJETOR '23



# TRANSPARENCA, DHJETOR 2023



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**PUBLIKIME NE FAQEN ZYRTARE**


Gjatë muajit Dhjetor 2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përmbushje të detyrimit ligjor, ka përditësuar në faqen zyrtare të tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të qenë më pranë publikut përmes pasqyrimit të veprimtarisë së tij të përditëshme.

Në faqen zyrtare <https://klp.al/> gjeni të publikuara të gjitha mbledhjet, aktivitetet dhe vendimet e marra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

# Lidhuni me KLP

Rruga “Ana Komnena”, ish- Fusha e Aviacionit, Poli i Drejtësisë

- <https://goo.gl/maps/yG36HH6m1VKAw16A9>



Llogaria zyrtare në Twitter

- [https://twitter.com/KLP\\_al](https://twitter.com/KLP_al)



Youtube

<https://www.youtube.com/channel/UCnFVsMbta9js1WUP3clGcw>

